




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 30.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **28.09.2020**, të parashtruar nga **Grupi I OE "EL BAU & SINANI ING" SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova** " me nr të prokurimit **651-20-2807-5-1-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 026 511** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet - kërkesa për ri-shqyrtim e **Grupit të OE "EL BAU & SINANI ING" SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova**" me nr të prokurimit **651-20-2807-5-1-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 026 511** e dt. **28.09.2020** kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës **23.09.2020** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

- 1. AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 23.09.2020**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Grupi I OE "EL BAU & SINANI ING" SH.P.K me datë **28.09.2020** ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova"** me nr të prokurimit **651-20-2807-5-1-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 026 511** Autoriteti Kontraktues me datë **30.09.2020** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar të gjitha pikat ankimore të Grupit të OE "EL BAU & SINANI ING" SH.P.K., ku të gjitha pretendimet ankimore bien poshtë dhe mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Gjithashtu ju njoftojme qe menjehere pas njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues te dt. **23.09.2020**, kemi pranuar emailin nga ju ku keni kerkuar qasje ne dokumentacionin e OE i cili eshte shpallur fitues per kete aktivitet.

AK ka konstatuar qe **Grupi i Operatorëve Ekonomik: K.N.T.SH. " Teuta - M " Sh.p.k.; N.T. "Rahovica Commerce"**, ka te plotesuar **Aneksin 3 kerkesa per sekrete afariste – kapacitetet ekonomike financiar si dhe kapacitetin teknik dhe profesional**, me arsyetimin **se te dhenat prej ketij tenderi –projekti mund ti perdorin per tender-projekte tjera.**

AK permes emailit me dt **24.09.2020** ka kerkuar nga **GR.OE K.N.T.SH. " Teuta - M " Sh.p.k.; N.T. "Rahovica Commerce"** qe te ju lejohet qasja e plote OE te cilet jane te interesuar. Me dt. **25.09.2020** **"TEUTA-M" SH.P.K** eshte pergjigjur permes emailit si me poshte:

Krejt ne fund sa i perket kerkeses suaj per lejimin ne qasje ne dokumentacion, ne me vetedije e kemi mbushur formularin e aneksit nr.3 sipas ligjeve te krpp-se per sekret afarist dhe cdo ndryshim i dokumentacionit i tenderit pasi te dorzohet ai permaban shkelje, dhe per kete nuk mund ta lejojme. Gjithashtu mbi gjithhecka ne besojme ne objektiviteten dhe vleresimin tuaj si prokurim ne momentin kur keni vendosur qe neve si OE te na shpallni fitues ne tenderin ne fjale.

Autoriteti Kontraktues duke u bazuar ne Ligjin e LPP-se Neni 11 paragrafi 3,3.1,3.2,3.3 (Informatat Sekrete Afariste), ka rrespektuar kerkesen e Grupit i Operatorëve Ekonomik: K.N.T.SH. " Teuta - M " Sh.p.k.; N.T.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.

Izet Kurteshi
ZPZP

